



**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ILIRIA" Sh.p.k.**

Ne Tirane me daten 1995 (nentedhete e pese), une i nenshkruari *Ilir MANE*, i biri i Leskos, lindur ne Fier me 23.04.19.672, banues ne Tirane, me adrese: Rr."Grigor Heba", Pall.45/1, Sh.2, Ap.26, me cilesine ortakut te vetem, me vullnetin tim te lire e te plote, vendosa te krijoj Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin: "**ILIRIA**" Sh.p.k., me qender ne Tirane.

HYRJE

Neni 1

Ne kuptim te ketij akti, themelues eshte *Ilir MANE*, ortakut i vetem themelues i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "**ILIRIA**" Sh.p.k.

Neni 2

Qellimi i ketij akti themelues eshte krijimi i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar me "**ILIRIA**" Sh.p.k., me seli ne Tirane, dhe perspektive shtrirje ne te gjitha teritorin e R.Shqiperise.

Neni 3

Shoqeria "**ILIRIA**" Sh.p.k. eshte person juridik dhe veprimtaria e saj rregullohet sipas Statutit, ligjit 7696 date 7.04.1993 "Per sherbimin e rojeve civile te armatosura" dhe Vendimit te K.M. Nr.210, date 10.05.1993 si dhe akteve te tjera te Legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Objekti

Neni 4

Objekti i Shoqerise "**ILIRIA**" Sh.p.k., do te jete :

Sherbimi i Rojeve Civile te Armatosura, per ruajtjen e objekteve te ndryshme sipas kontrates qe do te lidhet ndermjet kesaj Shoqerije dhe personave juridike apo fizike qe kerkojne mbrojtjen e objekteve te tyre; duke mos perjashtuar mundesine e ruajtjes dhe te personave fizike, sipas kerkesave te paraqitura prej tyre dhe gjithmone sipas kontrates qe do te lidhet per kete qellim midis ketyre personave dhe Shoqerise ne fjale per *Sherbimin e Rojeve Civile te Armatosura*.

Neni 5

Shoqeria "**ILIRIA**" Sh.p.k., do te filloje aktivitetin e saj nga dita e regjistrimit ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Rrethit Tirane, si dhe pajisjes me lejen e ushtrimit te profesionit nga Zyra e Tatimeve te Rajonit perkates.

Neni 6

Shoqeria "**ILIRIA**" Sh.p.k., do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe mbi 10 vjet .

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise tregtare private "**ILIRIA**" Sh.p.k., arrin vleften 100.000 (njqind mije) leke. Ortaku i vetem, *Ilir MANE* e disponon kete shume, baras me 100%, e nenshkrueshme dhe e shlyeshme prej tij.

Bilanci, veprimtaria ekonomike, detyrimet

Neni 8

Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet shteterore, sigurimet shoqerore, etj.

Neni 9

Ortaku i vetem themelues ose persona te tjere te autorizuar prej tij, kane te drejte qe me nxjerrjen e bilanceve ekonomike, te perfitojne perqindjet e realizuara nga veprimtaria private.



Juridiksioni

Neni 10

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ILIRIA" Sh.p.k., e ka qendren e saj ne Tirane me adrese :
Hoteli i Oficereve, Rr. "Marsel Kashen"

Neni 11

Shoqeria "ILIRIA" Sh.p.k., mund te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithë teritorin e R. Shqiperise.

Neni 12

Te gjitha mosmarreveshjet me persona juridike e fizike, vendas ose te huaj, si dhe me organet shtetore, zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tirane .

THEMELUES

Ilir MANE



REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTE RI A-TIRANE

NR. *6033* REP

NR. *807* KOL

VERTETIM

Sot me daten *21.9.* 1995 (nentedhete e pese), ne Tirane, ne Zyren e Noterise Tirane, u paraqit personalisht para meje Noteres, **Ilir MANE**, per identitetin e te cilit u informova nga nga dokumenti i identitetit qe ai mbante, madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar. Ai deklaroi se **Akti i Themelimit** i mesiperm, i redaktuar jashte kesaj zyre, eshte sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe e nenshkroi ate rregullisht. Une Noterja e gjej kete veprim ne perputhje me Ligjen, e firmos rregullisht sipas Ligjes.



NOTE R E
VOJSAVA KARAPICI
TIRANE-TEL: 341 57